



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/04  
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 200.000 (dyqind mijë) euro si mbështetje financiare për Republikën e Shqipërisë, për qëllim të ndihmës në sanimin e dëmeve nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.
2. Mjetet financiare nga pika 1 e këtij vendimi merren nga Ministria e Financave me kod 201, nën programi Kontigjencat në Ministrinë e Financave me kod 28900 nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime dhe transferohen në Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, në kategorinë e shpenzimeve të rezervës. Këto mjete transferohen në Ministrinë e Financave nën programin Thesari me kod 11200 në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
3. Transferimi i mjeteve nga pika 2 e këtij vendimi tek Republika e Shqipërisë bëhet tek llogaria përkatëse e Thesarit në Bankën e Shqipërisë.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/04  
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave dhe Transfereve për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrje në programin e BE-së "Customs 2020" (*shqip: Dogana 2020*)
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave dhe Transfereve për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1 i këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/04  
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave dhe Transfereve për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrje në programin e BE-së "Fiscalis 2020".
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave dhe Transfereve për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1 i këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/04  
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5, paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafëve 2-3, të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MEPTINIS me nr. prot. 1184, datë 27.02.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Hekurudhat e Kosovës - Infrakos" Sh.A.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Për arsyet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Hekurudhat e Kosovës - Infrakos" Sh.A.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/04  
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**për shfuqizimin e Vendimit Nr. 20/64, të datës 11.09.2018**

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 20/64, i datës 11.09.2018, për aprovimin e Koncept dokumentit për ndryshimin e politikave fiskale dhe bujqësore për prodhimin e duhanit dhe cigareve në Kosovë.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/04  
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-112 për Tatimin në Normën e Akcizës në Kosovë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

për shfuqizimin e Vendimit Nr. 11/68, të datës 09.10.2018

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 11/68, i datës 09.10.2018.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi pas konsultimeve të zhvilluara në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/04  
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 400,000 euro për Ministrinë e Shëndetësisë për parandalimin e situatave të mundshme emergjente për epidemi.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Ministria e Financave me kod 201, nën programi Kontigjencat në Ministrinë e Financave me kod 28900 nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime dhe transferohen në Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, në kategorinë e shpenzimeve të rezervës.
3. Mjetet nga pika 2 e këtij vendimi transferohen në Ministrinë e Shëndetësisë me kod 206 nën programin Shërbimet Përkatëse Farmaceutike me kod 71300, në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/04  
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë, për themelimin e Grupit të ekspertëve të pavarur për të dizajnuar parimet udhëheqëse, skenaret dhe elementet e reformës së *Vettingut* në sistemin e drejtësisë, si në vijim:
  - 1.1 **Qerim Qerimi**, anëtar i Komisionit të Venedikut dhe profesor universitar, Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës (kryesues i Grupit të Ekspertëve);
  - 1.2 **Avni Puka**, profesor universitar, Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës;
  - 1.3 **Fisnik Korenica**, profesor universitar, Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës;
  - 1.4 **Visar Morina**, anëtar zëvendësues i Komisionit të Venedikut dhe profesor universitar, Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës;
  - 1.5 **Kujtim Kerveshi** - avokat;
  - 1.6 **Arbëresha Loxha**, Drejtoreshë Ekzekutive, Grupi për Studime Juridike dhe Politike;
  - 1.7 **Ehat Miftaraj**, Drejtor Ekzekutiv, Instituti i Kosovës për Drejtësi;
  - 1.8 **Ariana Qosaj-Mustafa**, eksperte e sundimit të ligjit dhe e së drejtës gjinore, KIPRED dhe Rrjeti i Grave të Kosovës;
  - 1.9 **Arton Demhasaj**, Drejtor Ekzekutiv, Organizata Çohu;
  - 1.10 **Kreshnik Gashi** - jurist, autor i emisionit 'Drejtësia në Kosovë' - Birn, InternewsKosova
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë që pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të kërkoj nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, të propozojnë nga një përfaqësues në Grupin e ekspertëve.




3. Grupi i Ekspertëve do të ketë mandat për çështjet si në vijim:
  - a. të ofroj një studim kuptimplotë, të thelluar dhe të argumentuar mbi mundësinë e fillimit të një procesi të *vettingut* në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës;
  - b. të ofroj një pasqyrë të qartë të skenarëve (nga më i thelluari deri tek më sipërfaqësori) mbi të cilët mund të bazohet reforma e *vettingut* të sistemit të drejtësisë, në dritën e së drejtës kushtetuese dhe sistemit ligjor të Republikës së Kosovës, parimeve ndërkombëtare të pavarësisë, paanshmërisë, integritetit dhe profesionalizmit të funksionit gjyqësor e prokurorial, të së drejtës për të drejtat e njeriut kryesisht të bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, dhe të ligjeve të buta që rrjedhin kryesisht nga forumet e ekspertëve siç janë Komisioni i Venecias dhe Këshillit të Evropës në përgjithësi, por jo vetëm;
  - c. të përcaktoj elementet e reformës së *vettingut* në sistemin e drejtësisë, sipas secilit skenar/alternativa të identifikuar, dhe të identifikoj rreziqet, mundësitë, përparësitë dhe dobësitë e secilit skenar të studiuar;
  - d. të përcaktoj metodën e përfshirjes konstituive të elementit ndërkombëtar në procesin e *vettingut*, dhe mënyrën se si duhet ushtruar përpjekja për të ndërtuar konsensusin parlamentar për një ndryshim të tillë madhor;
  - e. të identifikoj rastet e suksesshme të krahasueshme, dhe t'i sugjeroj/pasqyroj elementet e dobishme që mund të përfshihen në reformën e *vettingut* në rastin e Kosovës.
4. Grupi i Ekspertëve deri me datë 30 maj 2020 Qeverisë dhe Ministrisë së Drejtësisë do t'i paraqesë një raport me skenar/alternativa për Reformën e *Vettingut* në Sistemin e Drejtësisë dhe opcionet që duhet ndjekur për realizimin e reformës së *vettingut* në sistemin e drejtësisë të mbështetur në objektivitet, integritet profesional dhe më së shumti në parime që e bëjnë reformën të mbrojtur nga interferimi i kujtdo.
5. Grupi i Ekspertëve do të kryej këtë shërbim *pro bono* (pa asnjë kompensim financiar). Ai nuk përbën trupë qeveritare e as njësi të institucioneve publike. Ai do të jetë plotësisht i pavarur në dhënien e vlerësimit, dhe nuk do të ndikohet nga pritjet apo perspektivat e askujt në dhënien e ekspertizës së saj. Ai funksionon mbi premisen e punës vullnetmirë, në të mirë të interesit publik, e të bazuar në etikën profesionale.
6. Mbledhjet e Grupit të Ekspertëve do t'i thërras Kryesuesi, dhe mbledhjet e tij këshilluese do të mbahen pa praninë e ndonjë anëtari të Qeverisë, apo kujtdo tjetër, me përjashtim nëse Grupi i ekspertëve vendos të thërras në takimet e tyre ekspertë të vendeve që kanë kaluar procesin e *vettingut*.
7. Anëtarët e Grupit të Ekspertëve që i përkasin organizatave të shoqërisë civile, mund të vetë-zëvendësohen përkohësisht nga ekspertë të tjerë të organizatës të cilën ata e përfaqësojnë, nëse për një çështje të ngushtë një përfaqësues tjetër i asaj organizate gëzon një ekspertizë më të ngushtë profesionale. Rregullat tjera për funksionimin e grupit, vendosen me konsensus.
8. Raporti përfundimtar mbi skenarët e Reformës së *Vettingut* në Sistemin e Drejtësisë do të shfrytëzohet si bazë mbi të cilin mëpastaj Qeveria dhe Ministria e Drejtësisë do të kërkoj bashkëpunimin dhe koordinimin e faktorit ndërkombëtar (parasëgjithash ShBA-së,

Gjermani-së, Mbretërisë së Bashkuar dhe Komisionit Evropian) dhe akterëve parlamentar në Republikën e Kosovës.

9. Obligohet Ministria e Drejtësisë që Grupit të Ekspertëve t'i ofroj mbështetjen e nevojshme teknike, nëse kjo kërkohet nga Grupi i Ekspertëve.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/04  
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5, paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 2 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009, në pajtim me nenin 9 paragrafi 7 të Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MEPTINIS me nr. prot. 1204, datë 28.02.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Shkarkohen drejtorët e Bordit Mbikëqyrës të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Trepça" Sh.A. që janë emëruar me vendimin nr. 01/39 të 4 prillit 2018 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Për arsytet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Trepça" Sh.A.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/04  
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, me qëllim të zbatimit të vendimit (Nr. 07-V-005) e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbledhjes plenare të mbajtur më 03 shkurt 2020 dhe Rregullore (QRK) - Nr. 05/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, datë 20 shkurt 2020, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-021 (LMFPP), Ligjin Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (GZ, Nr. 07/2019, dt. 01.03.2019), Ligji nr. 06/L -133 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Ligji Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (LKBFP), Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Nr. 07-V-007), datë 13.02.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Autorizohen Sekretarët e Përgjithshëm apo zëvendësit e tyre, që të ushtrojnë funksionin e Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA) për tërë sistemin ministror në kuptimin e menaxhimit të financave publike dhe llogaridhënies, sipas riorganizimit dhe emërtimeve të përcaktuara të ministrive bazuar në Rregulloren (QRK) - Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.
2. Me qëllim të zbatimit të nenit 10 të LMFPP dhe për qëllim të pikës 1 të këtij vendimi, ministrinë e bashkuara, përkatësisht riorganizuar, konsiderohen si një organizatë buxhetore.
3. Me qëllim të zbatimit të dispozitave të LMFPP dhe akteve tjera nën-ligjore, Zyrtari Kryesor Financiar dhe zyrtarët tjerë financiarë vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre sipas autorizimeve në fuqi, nëpër programet buxhetore të organizatave buxhetore sipas kodeve aktuale buxhetore dhe mbajtësve të buxhetit, të zgjatur në pajtim me nenin 24 të LMFPP si dhe vendimin për zgjatjen e ndarjeve buxhetore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (Nr. 07-V-007), datë 13.02.2020, mbi bazën e ndarjeve në Ligjin nr. 06/L-133 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.
4. Me qëllim të zbatimit të dispozitave të LKBFP dhe akteve tjera nën-ligjore sipas pikës 3, në rastet kur ministrinë e ndikuara nga riorganizimi dhe fushat e përgjegjësisë janë të shpërndara në dy a më shumë ministri të ri-organizuar apo edhe shpërbëra, llogaridhënia nga ZKF dhe zyrtarët tjerë financiarë duhet të behet tek më shumë se një ZKA, në pajtim me LMFPP.



5. Në situatën sipas pikës 4, llogaridhënia bëhet mbi strukturën dhe ndarjet aktuale buxhetore, për buxhetin përkatës, tek ZKA e Ministrive të cilat kanë atë funksion në kuadër të fushës së përgjegjësisë si dhe realizohet në koordinim midis ZKA-ve, për fushat e përgjegjësisë së sistemit ministror.
6. Ky rregullim i përkohshëm sipas pikave 1-5 vlen vetëm për ministritë e ndikuara sipas vendimit Nr. 03/03 të datës 19.02.2020 dhe vetëm deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Buxhetin për vitin 2020.
7. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të buxhetit për vitin 2020 dhe deri në miratimin e rregulloreve individuale për organizim të brendshëm të ministrive të ndikuara dhe ri-organizuara, secila ministri është organizatë buxhetore dhe ka vetëm një ZKA, një ZKF dhe zyrtarë financiar në pajtim me LMPPP.
8. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve si dhe Ministritë e ndikuara nga ky vendim për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë